



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 41 par. 3.4 të Ligjit për Avokatinë, nenit 83 par.2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31/07/2014 nxjerr:

**RREGULLORE PËR QENDRËN TRAJNUESE PËR AVOKATË**

**KAPITULLI I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Më këtë rregullore përcaktohet statusi, funksionet, organizimi, mënyra dhe kushtet e punës së Qendrës Trajnuese për Avokatë (më tej Qendra Trajnuese).

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen nga të gjitha organet e Odës së Avokatëve të Kosovës (më tej OAK) si dhe të gjithë personat që marrin pjesë në procesin e trajnimeve, provimeve apo aktiviteteve tjera në kompetencë të Qendrës Trajnuese.

**KAPITULLI II  
STATUSI, FUNKSIONET DHE ORGANET E QENDRËS TRAJNUESE**

**Neni 3  
Emërtimi**

Emërtimi i Qendrës Trajnuese është "Qendra Trajnuese për Avokatë".

**Neni 4**

## Statusi i Qendrës Trajnuese

1. Qendra Trajnuese është njësi profesionale e Odës së Avokatëve, qëllimi i të cilës është ngritja e njohurive dhe shkathtësive teorike dhe praktike profesionale e personale për ushtrim të pavarur, profesional dhe etik të profesionit të avokatisë, për anëtarësinë e OAK-së<sup>1</sup> dhe profesioneve tjera nga juristët e Kosovës.
2. Selia e Qendrës Trajnuese është në Prishtinë.

### Neni 5

#### Vula dhe logoja e Qendrës Trajnuese

1. Qendra Trajnuese e OAK-së ka logon dhe vulën e saj e cila duhet të përdoret krahas logos së OAK-së.
2. Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dy rrahtë në të cilët shënohet teksti si më poshtë në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe:
  - a. në rrethin e jashtëm shënon: Oda e Avokatëve të Kosovës;
  - b. në rrethin e brendshëm shënon Qendra Trajnuese për Avokatë;
  - c. në qendër është e vendosur logoja e Qendrës Trajnuese;
3. Logoja e Qendrës Trajnuese miratohet nga Këshilli Drejtues i OAK-së.

### Neni 6

#### Funksionet e Qendrës Trajnuese

1. Qendra Trajnuese kryen këto funksione:
  - 1.1 Arsimin e Vazhdueshëm Ligjor Obligativ për Avokatë;
  - 1.2 Organizimin e provimit për specializimin e avokatëve;
  - 1.3 Organizimin e Provimit të Etikës për kandidatët për Avokatë;
  - 1.4 Kursin Përgatitor për Avokat<sup>2</sup>;
  - 1.5 Kurse Trajnuese për praktikantë;
  - 1.6 Kurse trajnuese për anëtarët vullnetarë;
  - 1.7 Përgatitjen e kandidatëve për provimin e jurisprudencës;
  - 1.8 Siguron cilësi të programeve trajnuese duke miratuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha programet e ofruara;
  - 1.9 Vlerëson nevojat për trajnime për përfituesit e vet;
  - 1.10 Organizon trajnime për trajnues dhe i certifikon trajnuesit;
  - 1.11 Auditon bartësit për dhënien e kredive AVLO;
  - 1.12 Vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucione të ngjashme vendore dhe të huaja lidhur me kompetencat e saj;
  - 1.13 Kryen punë hulumtuese dhe bashkëpunon me institucionet shkencore në funksion të zbatimit të kompetencave të veta;

---

<sup>1</sup> Neni 4 i Statutit të OAK-së

<sup>2</sup> Neni 8 i Statutit të OAK-së

1.14 Mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Qendrën Trajnuese;

1.15 Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të OAK-së.

### **Neni 7**

#### **Organet dhe stafi i Qendrës Trajnuese**

1. Qendra Trajnuese drejtohet nga Këshilli i Qendrës.
2. Në kuadër të Qendrës Trajnuese është i angazhuar stafi i përhershëm për zbatim të të funksioneve të Qendrës Trajnuese.

### **Neni 8**

#### **Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues i Qendrës Trajnuese (më tej; Këshilli) është organ drejtues i Qendrës Trajnuese.
2. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë sipas strukturës si më poshtë;
  - 2.1 Tre (3) avokatë me përvojë mbi 5 vite në avokati;
  - 2.2 Një (1) Profesor universitar nga Fakulteti Juridik;
  - 2.3 Një (1) Përfaqësues nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit emërohen nga Këshilli Drejtues i OAK-së.
4. Mandati i anëtarëve të përbërjes së parë të Këshillit Drejtues të Qendrës Trajnuese është i ndryshëm. Dy (2) nga anëtarët kanë mandat dy (2) vjeçar, ndërsa tre (3) anëtarët tjerë kanë mandat katër (4) vjeçar. Mandati i anëtarëve të përbërjes së parë caktohet me short. Mandati i anëtarëve të përbërjeve tjera është 4 vjet.
5. Anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.
6. Kryetari i Këshillit përfaqëson Këshillin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit dhe kryen përgjegjësi të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe akte tjera.
7. Kryetari i Këshillit i raporton Këshillit Drejtues të OAK-së së paku një herë në vit lidhur me punën e Qendrës dhe sipas kërkesës së Këshillit Drejtues.

### **Neni 9**

#### **Kompetencat Këshillit**

1. Kompetencat e Këshillit janë:
  - 1.1. Menaxhimi dhe mbikëqyrja e punës së Qendrës Trajnuese;
  - 1.2. Hartimi i draft-rregulloreve në kuadër të fushëveprimtarisë së Qendrës Trajnuese;

- 1.3. Miratimi i strategjisë dhe planit të punës së Qendrës Trajnuese
  - 1.4. Përcaktimi i programeve trajnuese të Qendrës Trajnuese;
  - 1.5. Përcaktimin e prioriteteve për zbatimin e programeve të trajnimeve;
  - 1.6. Miratimin e projektbuxhetit të Qendrës Trajnuese;
  - 1.7. Miratimi i rregullores mbi përzgjedhjen e trajnuesve dhe përzgjedhë trajnuesit;
  - 1.8. kryerja e punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.
2. Këshilli Drejtues mund të formoj grupe pune apo komisione profesionale të përhershme ose ad hoc pa kompetencë vendimmarrëse për të përmbushur funksionet e Qendrës Trajnuese.

### **Neni 10**

#### **Mënyra e punës dhe e vendimmarrjes së Këshillit**

1. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari i Këshillit dhe me propozimin e së paku një të tretës (1/3) të anëtarëve të Këshillit.
2. Mbledhja mbahet nëse janë prezent shumica e anëtarëve të Këshillit.
3. Këshilli vendimet i merr me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve prezent.
4. Këshilli mbanë mbledhje të rregullta çdo muaj, por mund të thirret edhe më shpesh nëse është e nevojshme.

### **Neni 11**

#### **Pushimi i funksionit të anëtarit të Këshillit**

1. Anëtarit të Këshillit i pushon funksioni nëse:
  - 1.1 i skadon mandati për të cilin është zgjedhur;
  - 1.2 jep dorëheqje;
  - 1.3 i pushon funksioni apo marrëdhënia e punës në institucionin që e ka propozuar;
  - 1.4 nëse nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit pa arsye;
  - 1.5 është shkarkuar;
2. Vendimin për pushimin e funksionit të anëtarit të Këshillit e nxjerrë Këshilli Drejtues i OAK-së.

### **Neni 12**

#### **Pagesa e Anëtarëve të Këshillit**

1. Anëtarët e Këshillit për mbledhjet e mbajtura gëzojnë të drejtë në mëditje.
2. Anëtarët e Këshillit marrin mëditje për çdo mbledhje të mbajtur mirëpo shuma e përgjithshme e mëditjeve nuk mund të kaloj dyfishin e mëditjes së përcaktuar për

një muaj, përjashtimisht kryesuesit të Këshillit i cili nuk mund të kaloj trefishin e mëditjes së përcaktuar për një muaj;

3. Shuma e kompensimit për anëtarët e Këshillit të QTA përcaktohet nga Këshilli Drejtues i OAK-së.

### **Neni 13**

#### **Koordinatori i Qendrës Trajnuese**

1. Koordinatori i Qendrës Trajnuese menaxhon dhe koordinon aktivitetet e Qendrës.
2. Kompetencat e Koordinatorit janë;
  - 2.1 Zbaton vendimet e Këshillit;
  - 2.2 Zbaton programet trajnuese të Qendrës;
  - 2.3 Përfaqëson Qendrën Trajnuese para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
  - 2.4 Propozon projekt buxhetin vjetor të Qendrës;
  - 2.5 Merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues të OAK-së dhe Këshillit Drejtues të Qendrës Trajnuese;
  - 2.6 Mbikëqyrë punonjësit e Qendrës;
  - 2.7 Përgatitë raporte të rregullta vjetore dhe raporte tjera sipas kërkesës së Këshillit;
  - 2.8 Kryen edhe punët e tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Qendrës;
3. Koordinatori është zyrtari më i lartë dhe kryesor i Qendrës.
4. Koordinatori për punën e tij rreth funksionimit dhe zbatimi të funksioneve të Qendrës i përgjigjet Këshillit Drejtues të Qendrës Trajnuese, ndërsa për çështjet tjera Drejtorit Ekzekutiv siç përcaktohet me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës.

### **Neni 14**

#### **Të punësuarit në Qendrën Trajnuese**

1. Qendra Trajnuese ka numër të caktuar të zyrtarëve për kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo-teknike. Numri i zyrtarëve përcaktohet me aktet normative për organizimin brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së OAK-së.
2. Numri i zyrtarëve në Qendër përcaktohet nga Këshilli Drejtues i OAK-së, me propozimin e Këshillit të Qendrës Trajnuese.
3. Dispozitat e legjislacionit për të punësuarit e OAK-së, zbatohen edhe për zyrtarët e Qendrës Trajnuese.
4. Me kërkesën e Kryetari të Këshillit të Qendrës Trajnuese, Drejtori Ekzekutiv i OAK-së mund të caktoj të punësuarit tjerë të OAK-së në mbështetje të aktiviteteve të Qendrës Trajnuese.
5. Qendra Trajnuese angazhon edhe praktikantë/student për të mbështetur zbatimin e funksioneve të saj.

### KAPITULI III AKTIVITETET E QENDRËS TRAJNUESE

#### Neni 15 Programi i Trajnimeve

1. Këshilli i Qendrës Trajnuese e përcakton Programin Kornizë të Trajnimeve i cili duhet të certifikohet<sup>3</sup> nga Këshilli Drejtues i OAK-së.
2. Qendra Trajnuese fillon hartimin e programit trajnues për vitin vijues më së largu në muajin qershor të vitit aktual dhe e përfundon atë më së largu me 30 shtator të atij viti.
3. Programi i trajnimeve pas certifikimit nga Këshilli Drejtues së bashku me dokumentacionin tjetër të nevojshëm për zbatim të trajnimeve publikohen në web-faqen e OAK-së më së voni më datën 1 janar të vitit vijues, gjatë të cilit do të zbatohet programi trajnues.
4. Këshilli i Qendrës Trajnuese mund të rifreskon programin trajnues ashtu siç e konsideron të nevojshëm duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e përfituesve.

#### Neni 16 Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor Obligativ<sup>4</sup>

1. Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor Obligativ (më tej AVLO), organizohet nga Qendra Trajnuese, me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm dhe avancimit të shkathtësive dhe ekspertizës profesionale për avokatët.
2. Organizmi i AVLO zbatohet siç është përcaktuar me rregullore të veçantë.

#### Neni 17 Kursi Përgatitor për Avokatë<sup>5</sup>

1. Qendra Trajnuese organizon kursin përgatitor për aftësimin e kandidatëve për avokatë të cilët kanë parashtruar kërkesë për regjistrim në Regjistrin e Avokatëve.
2. Kushtet dhe procedura e organizimit të Kursit Përgatitor për Avokatë (KPA) do të përcaktohen me akt të veçantë nga Këshilli i Qendrës Trajnuese.
3. Programi dhe kohëzgjatja e trajnimit për kandidatët nga paragrafi 1 i këtij neni do të miratohet nga Këshilli Drejtues i OAK-së<sup>6</sup> sipas propozimit të Këshillit të Qendrës Trajnuese.

---

<sup>3</sup> Neni 7 i Rregullores per Arsimimin e Vazhduar Ligjor Obligativ

<sup>4</sup> Neni 13 par. 1 i Ligjit për Avokatinë

<sup>5</sup> Kursi përgatitor për Avokat - neni 8 i Statutit të OAK-së

<sup>6</sup> Neni 8 pika 2 e Statutit të OAK-së

4. Kandidatëve nga paragrafi 1 i këtij neni për kryerjen me sukses të KPA-së, Qendra Trajnuese u lëshon dëshmi.

### **Neni 18**

#### **Specializimi i avokatëve**

Qendra Trajnuese administron procesin e specializimit për avokatë bazuar në Rregulloren për Specializime, rregullat e procedurës dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Drejtues.

### **Neni 19**

#### **Provimi i Etikës për kandidatët për Avokatë**

Provimi i Etikës për avokatë organizohet nga Qendra Trajnuese në përputhje me aktet normative dhe Rregulloren për Provimin e Etikës së Avokatëve.

### **Neni 20**

#### **Kurse trajnuese për praktikantë<sup>7</sup>**

1. Qendra Trajnuese harton programe trajnimi adekuate për aftësimin profesional të praktikantëve të OAK-së i cili miratohet nga Këshilli Drejtues.
2. Struktura, kohëzgjatja, kushtet e pjesëmarrjes dhe zbatimi i tij përcaktohen nga Këshilli i Qendrës Trajnuese.

### **Neni 21**

#### **Kurse trajnuese për anëtarët vullnetarë të OAK-së**

3. Qendra Trajnuese harton programe trajnimi për aftësimin profesional të anëtarëve vullnetarë të OAK-së.
4. Zbatimi i këtij përcaktohet nga Këshilli i Qendrës Trajnuese.

### **Neni 22**

#### **Përgatitja e kandidatëve për provimin e jurisprudencës**

1. Qendra Trajnuese do të organizoj trajnime profesionale për kandidatët e paraqitur për dhënien e provimit të jurisprudencës.
2. Programi dhe kohëzgjatja e trajnimit miratohet nga Këshilli i Qendrës Trajnuese në pajtim me përmbajtjen e Provimit të Jurisprudencës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

---

<sup>7</sup> Neni 13 par. 2 i Ligjit për Avokatinë

3. Për trajnimet e ofruara nga Qendra Trajnuese kandidatët do të paguajnë një shumë të caktuar nga Këshilli Drejtues i OAK-së në pajtim me kushtet e tregut dhe ligjet në fuqi.
4. Pjesëmarrësve në trajnime nga paragrafi 1 i këtij neni, pas përfundimit të trajnimit, u lëshohet certifikatë.

### **Neni 23**

#### **Provimi i Pranimit për avokatët e huaj<sup>8</sup>/Provimi i përshtatshmërisë për avokatët e huaj (PPO)<sup>9</sup>**

1. Qendra Trajnuese organizon provimin e pranimit/provimin e përshtatshmërisë për avokatët e huaj (PPO) sipas strukturës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues i OAK-së.
2. Përbërjen e komisionit, kushtet dhe procedurën e punës e përcakton Këshilli Drejtues i OAK-së.

### **Neni 24**

#### **Trajnuesit**

1. Trajnuesit e Qendrës Trajnuese janë profesionistë nga radha e avokatëve, gjyqtarëve, prokurorëve, ligjëruesve universitar dhe profesionistë të degëve të ndryshme nga fusha juridike si dhe profesionistë të fushave tjera që kanë të bëjnë me shkathtësitë interdisiplinare dhe personale të avokatëve.
2. Kushtet për tu angazhuar si trajnues dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre do të përcaktohen me akt të veçantë nga Këshilli i Qendrës së Trajnuesve.
3. Trajnuesit në Qendrën Trajnuese do të angazhohen me kontratë me të cilën do të përcaktohen edhe përgjegjësitë e tyre në raport me Qendrën Trajnuese.
4. Trajnuesit e Qendrës Trajnuese duhet të zbatojnë Doracakun për Trajnues të Qendrës.
5. Trajnuesit e Qendrës Trajnuese janë të detyruar të marrin pjesë në programet trajnuese për zhvillim të metodologjive trajnuese.
6. Këshilli i Qendrës Trajnuese i propozon për miratim Këshillit Drejtues të OAK-së shumën e pagesës për trajnuesit e Qendrës.

### **Neni 25**

#### **Monitorimi, vlerësimi dhe miratimi i programeve trajnuese**

---

<sup>8</sup> Neni 3 par. 3.1 pika d e Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj (mbase këtu bëhet fjalë për Provimin e Etikës)

<sup>9</sup> Neni 4 i Rregullores për Licencimin e Avokatëve të Huaj



1. Me qëllim të mbështetjes së gjithanshme të avokatëve në ngritjen e shkathtësive profesionale dhe personale dhe në përmbushjen e obligimit për ndjekjen e trajnimeve, Këshilli i Qendrës Trajnuese mund të akreditoj bartës<sup>10</sup> për dhënien e kredive edhe për subjekte tjerë jashtë OAK-së.
2. Këshilli i Qendrës Trajnuese duhet të certifikoj të gjitha kreditë e fituara nga ana e avokatëve në trajnimet që nuk janë organizuar apo administruar nga Qendra Trajnuese, por nga bartësit e akredituar.  
Qendra Trajnuese do të përcaktoj rregulla të veçanta për aplikimin e bartësve për të ofruar kredi AVLO.

#### **Neni 26**

#### **Vlerësimi i nevojave për trajnime**

1. Qendra Trajnuese përcakton mekanizmat për identifikimin e nevojave trajnuese për avokatët dhe përfituesit tjerë të trajnimeve.
2. Pyetësi për Vlerësimin e Nevojave Trajnuese të avokatëve duhet të dërgohet tek të gjithë avokatët para ose në Ditën e Avokatisë.
- 3.

#### **Neni 27**

#### **Bashkëpunimi me Degët Regjionale<sup>11</sup> dhe Komitetet**

Qendra Trajnuese mbështet aktivitetet e Degëve Regjionale dhe Komiteteve të OAK-së të cilat kanë për qëllim ngritjen e përhershme profesionale të avokatëve dhe praktikantëve.

#### **Neni 28**

#### **Raporti Vjetor**

Qendra Trajnuese përgatitë raportin vjetor për punën e Qendrës jo më vonë se data e përgatitjes së Raportit Vjetor të OAK-së.

#### **Neni 29**

#### **Mjetet dhe kushtet e punës**

Mjetet dhe kushtet e punës të Qendrës Trajnuese sigurohen nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

## **KAPITULLI V FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA**

<sup>10</sup> Neni 2 par. 2 i Rregullores për Arsimimin e Vazhduar Ligjor të Obliguar për Avokatë

<sup>11</sup> Neni 4 par.4 I Rregullores për Degët Regjionale të OAK-së

**Neni 30**  
**Buxheti dhe financimi i Qendrës Trajnuese**

1. Qendra Trajnuese financohet nga taksa për AVLO, gjobat e arkëtuara nga mos përmbushja e kredive AVLO, taksa licencuese për praktikantë, taksa për provimin nga Kodi i Etikës profesionale të Avokatëve, taksa për specializimin e avokatëve; taksa për trajnimet për provimin e Jurisprudencës si dhe burime tjera të përcaktuara Këshilli Drejtues.
2. Këshilli i Qendrës Trajnuese duhet të miratoj projekt buxhetin e Qendrës për vitin vijues, më së largu deri më datën 15 tetorit të vitit aktual. Projektbuxheti i QTA-së i dërgohet për aprovim Këshillit Drejtues të OAK-së.
3. Qendra Trajnuese ka llogarinë e saj të veçantë nga OAK.
4. Nëse buxheti i Qendrës Trajnuese është i vogël dhe rrezikohet përmbushja e obligimeve të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera të OAK-së, Këshilli Drejtues i OAK-së, mund të alokoj fonde nga buxheti i OAK-së për të mundësuar përmbushjen e përgjegjësive të Qendrës.

**Neni 31**  
**Donacionet**

Përveç të hyrave të përcaktuara në nenin 30 të kësaj rregullore, Qendra Trajnuese mund të pranojë donacione shtesë nga donatorë vendor dhe ndërkombëtar.

**Neni 32**  
**Mbikëqyrja financiare**

Qendra Trajnuese menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e saj, i nënshtrohet auditimit të brendshëm në përputhje me aktet normative të OAK-së dhe kontrollit të Këshillit Drejtues të OAK-së .

**KAPITULLI VI**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 33**  
**Dispozitat Kalimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, anëtarët e Këshillit Drejtues të Qendrës Trajnuese do t'i kryejnë detyrat deri në mbarimin e mandatit të tyre siç është përcaktuar në nenin 8 pika 4 të kësaj Rregullore. Kjo është përbërja e parë Këshillit të Qendrës Trajnuese.
2. Të punësuarit në Qendrën Trajnuese, vazhdojnë të punojnë në pajtim me dispozita e kësaj Rregullore.
3. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, do të nxirren aktet tjera të parapara me këtë Rregullore.

4. Deri në nxjerrjen e akteve sipas kësaj Rregullore, zbatohen aktet normative dhe vendimet të cilat janë në fuqi.

**Neni 34**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës.

**Av. Ibrahim Z. Dobruna**  
**Kryetari i OAK-së**